

REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA KOLONJE

“REHABILITIMI I DIGES SE REZERVUARIT TE GJONÇIT”

SPECIFIKIME TEKNIKE

Tirane, Dhjetor 2021

PERMBAJTJA

1. Hyrje	4
2. Te pergjithshme	4
2.1 Pershkrimi I Punimeve	4
3. Realizimi i Punimeve.....	5
3.1 Ditari i kantjerit	6
3.2 Inspektimi	6
3.3 Materiali Mbushes	6
3.3.1 Vetite e Materialeve.....	6
3.3.2 Depozitimi i Perkohshem.....	7
3.3.3 Punimet e dheut dhe Ngjeshja.....	7
3.3.4 Shtresa vegjetale mbi Skarpaten e Bjefit te Poshtem	7
4. Betonet	7
4.1 Cilesia e Ujerave	8
4.2 Cimento	8
4.3 Inertet	9
5. Ujleshuesi.....	9
5. 1 Tubacioni ujleshuesit.....	9
6. Sharkkuesi katastrofik.....	10
6.1 Inspektimet	10
6.2 Realizimi i punimeve	10
6.3. Ura mbi Shkarkues	10

7. Kurora e diges dhe mbrojtja e skarpates se Bjefit te Siperm.....	10
7.1 Veshja me gure.....	10
7.2 Punimet e mbushjes per nivelacion dhe Ngjeshja	10
7.3 Parapeti	11
8. Matjet dhe Pagesat	11

SPECIFIKIMET TEKNIKE

1. Hyrje

Ky dokument eshte pjese e Dokumentave dhe e Kerkesave te Pergjitheshme per Kryerjen e Punimeve te Kontrates dhe duhet lexuar se bashku me dokumentet e tjera te kontrates te cilat perfshijne, por nuk kufizohen me :

Vizatimet

Shenimet dhe specifikime te veçanta Teknike ne fletet e vizatimeve

Volumet e Punimeve te pasqyruara ne preventivin permbledhes se bashku me shenimet perkatese

Nese vihet re ndonje mosrakordim ndermjet ketyre shenimeve dhe atyre te pasqyruara ne fletet e vizatimeve apo preventivave , keto te fundit kane perparesi .

2. Te pergjitheshme

2.1 Pershkrimi I Punimeve

Punimet konsistojne ne nje seri masash rehabilituese ne nje dige dheu, konkretisht ne Digen e rezervuarit te Gjonçit, ne rrethin e Kolonjës

Keto punime rehabilituese konsistojne ne nje seri masash te ndryshme te cilat perfshijne por nuk kufizohen vetem me :

- Pastrimi nga bimesia dhe sistemimi skarpatave te anes se sipërme te diges.
- Pastrimi nga bimesia dhe sistemimi skarpates se poshteme te diges perfshi germime e sisteme te nevojshme per rrafshimin e dherave ne zona te eroduar.
- Marrja e masave mbrojtjes te diges ne zonat me kalldrem te demtura ose te munguar kryesisht ne afersi te kreut te skarpates se anes se sipërme.
- .
- Sistemimi e rrasfimi kuroes se diges . Parashikimi I nje parapeti beton arme ne zonen ku kreu i kurores egzistuese eshte demtuar ose eshte ulur, duke zvogluar

keshtu ne nje mase te palejuaeshme frankon e diges nen vleren e parashikuar ne projektin origjinal.

- Punimet ne kurore perfshijne edhe nivelimin dhe ndertimin e nje rruge sherbimi pergjate saj.
- Rehabilitimi i shkarkuesit katastrofik siperfaqesor automatik, qe mban nen kontroll (mban ne nje kuote te caktuar nivelin e ujit ne rezervuar).
- Punime kullimi qe perfshijne kullimin e kurores, kulluesit ne skarpaten e anes se poshteme te diges dhe ne thembren e saj
- Riparimin e ujleshuesit ., ne anen e djathte te trupit te diges (perfshi eliminimin e rrjedhes , filtrimit te ujit ne puseten e daljes. Germi e mbushje me zhavor te zones ku do te zbulohet tuibacioni ujleshuesit. Rindertimi i pustes daljes duke nderruar edhe saraçineskat . Punime te pjeseshme ne puseten e brendshme.etj.
-
- Parashikimi I nje numri instrumentash monitorimi si: Pjezometra per matjen e nivelit te ujit e presionin e poreve ne trupin e diges; Monumentet ose Blloqe betoni te cilet sherbejne per monitorimin e uljeve te trupit te diges; Lata per matjen e nivelit te ujit ne rezervuar; Kaperderdhes per matjen e prurjes se filtrimeve nga trupi i diges.
- Punime te tjera te vogla dhe permiresime nga pikpamja e sigurise etj.

3. Realizimi i punimeve.

Fillimisht nje pjese e punimeve do te filloj te kryhet kushtet aktuale me prezenc uji ne ne kupen e rezervuarit . Me pas per nje pjese tjeter e punimeve do te kryhen kur rezervuari te jete bosh dhe te jete garantuar niveli minimal i ujit nepermjet mbajtjes hapur te ujeleshuesit.

Eshte e rendesishme te theksohet se Punimet per riparimin e ujleshuesit ne skarpaten e poshteme duhet te kryhen ne seksione jo shume te gjera me qellim minimizimin e riskut te paqendrueshmerise te skarptave gjate kryerjes se punimeve te germimit apo te mbushjes. Po ashtu nuk eshte e lejueshme qe siperfaqet e germuara te lihen te ekspozuara per nje kohe te gjate, perndryshe, shtresa e perjaruar duhet te hiqet dhe te largohet nga vendi i kryerjes se punimeve.

Kontraktori duhet te percaktoje gjeresine maksimale te germimit qe mund te ndertohet me sigurine e nevojshme pa krijuar paqendrueshmeri te diges egzistuese duke minimizuar kohen e ekspozimit te materialit mbushes te germuar.

Ne koston e punimeve te germimit dhe te mbushjes me dh', kontraktori duhet te perfshije edhe masa te veçanta per te perballuar situaten nese shira te dendur mund te bien ose kane rene, gjate kohes se kryerjes e punimeve te stabilitetit te skapatave.

Pas shirave te dendur kontraktori duhet te riskarifikoje me shpenzimet e tij siperfaqet e demtuara, pas nje inspektimi dhe miratimi me shkrim nga supervizori.

Kryerja e punimeve do te behet ne prezencen e vazhdueshme te supervizorit, i cili duhet te asistojë ne te gjitha punimet qe nga germimet, punimet e maskuara, per riparimin e ujleshuesit , kontrolli i cilesise se materialit te perdorur, per mbushje etj.

Supervizori lejon me shkrim fillimin e cdo punimi pasi te jete siguruar se ata plotesojne kushtet e teknikes se sigurimit dhe kushtet teknike sipas projektit.

3.1 Ditari i Kantjerit

Te gjithë punimet do te regjistrohen ne ditarin e kantjerit, i cili hapet qe ne ditën e marrjes ne dorezim te sheshit te ndertimit dhe duhet te jete sipas standarteve ne fuqi, nje fletore me numer faqesh te shenuara dhe te firmosur nga kontraktori dhe supervizori.

Ne Ditar do te shenohen te gjithë aktivitetet duke filluar nga ngritja e kantjerit, pregatitjen e sheshit te ndertimit, proceset e ndertimit, vizitat dhe inspektimet e ndryshme qe behen ne objekt, etjere.

Nuk lejohet te griset asnje faqe e Ditarit.

3.2 Inspektimi

Kontraktori duhet te garantoje 5 dite pune me ane te nje shenimi me shkrim per inspektimet qe duhet te beje supervizori ne germimet para se te filloje mbushja me material. Atje ku materiali do te jete I dobët ose evidentohet sufozia supervizori instrukton kontraktorin per levizjen e me shume dherave apo per pershtatjen e profilit sipas vendit.

3.3 Materiali Mbushes

3.3.1 Vetite e Materialeve

Materiali i dale nga germimi per skarifikim ne siperfaqe nuk do te perdoret per rimbushje. Ai depozitohet ne vende qe miratohen nga autoritetet lokale.

Materiali qe do te perdoret per riprofilim te skarpates egzistuese, kryesisht zhavor do te merret nga karierat qe do te percaktohen nga supervizori dhe perfaesuesi i autoritetit kontraktor .

Supervizori mund te refuzoje perdorimin e materialit nese ai :

Nuk ka perberje te mire; Nuk eshte me lageshti optimale; Ka materiale organike ose te elementeve te jashtem te papranueshem; Nese gama e skeletit eshte me e vogel se 2 T/m³.

Kontraktori duhet te pregatise e te dorezoje per aprovim tek supervizori, metodologjine per zgjedhjen, grumbullimin e perkohshem dhe vendosjen ne dige te materialit. Duhet te beje prova te mbushjes lidhur me lageshtine optimale dhe gamen e skeletit.

3.3.2 Depozitimi i Perkohshem

Vend depozitimet e perkohshem te materialit duhet te jene te shenuar qartesisht ne terren, si edhe masat qe merren ne vend per mbrojtjen e materialit (zhavorit)

Perpara riperdorimit, supervizori mund te urdheroje heqjen e shtreses se sipërme nese konsiderohet I paperstashe i shkaktuar nga kushtet atmosferike ose aresye te tjera. Po ashtu mund te pezulloje punimet nese lageshtia e materialit rezulton e ndryshme nga ajo optimale.

3.3.3 Punimet e mbushjes dhe Ngjeshja

Skarpata egzistuese do te shkallezohet, skarifkohet dhe gervishet para fillimit te mbushjes sipas vijave te treguara ne vizatimet perkatese. Para se te filloje mbushjen Kontraktori duhet te kete ne dispozicion nje volum te mjaftueshem per mbushjen dhe ngjeshjen sipas standarteve te kerkuar.

Eshte detyre e kontraktorit qe te beje disa prova ne objekt per te percaktuar treguesit e dherave para dhe pas ngjeshjes. Ngjeshja do te behet me rul pa vibrim. Ne prani te supervizorit do te behen disa prova per percaktimin e lageshtise optimale dhe per percaktimin e numrit te kalimeve te rullit per te arritur Gamen e Skeletit. Keto prova duhet te shoqerohen me nje procesverbal i cili firmoset nga Kontraktori dhe Supervizori. Ky dokument ben pjese ne dosjen e dorezimit te punimeve.

3.4.4 Shtresa vegjetale me dhe mbi Skarpaten e Bjefit te Poshtem

Nje mbulesë me dhë, te mbjellur me bar, mbi skarpaten e rafshuar me makineri do te ndihmoje ne zvoglimin e demtimit te materialit mbushtes nen te.

4. Betonet

Receptura e Betonit

Kontraktori duhet te paraqese supervizorit per aprovim, nje metodologji lidhur me betonet qe do te perdoren dhe recepturen e perzierjes per pergatitjen e tyre te miratuar nga nje institucion i licensuar per kete qellim.

Riparimet

Betonet dhe hekurat e ekspozuara duhet te pastrohen mire dhe gjithë mbeturinat te largohen. Kontraktori duhet te trajtojë hekurat e ekspozuar me prajmer anti-ndryshk (Nitoprime Zincrich) ose ndonje aditiv te ngjashem te aprovuar dhe siperfaqja e betonit duhet te jete e pastruar me uje dhe e thate para se te aplokohet antindryshku.

Kur rekomandohet nga prodhuesi materiali mund te sprucohet ne menyre te vazhdueshme

Te gjitha produktet duhet te instalohen sipas rekomandimeve te prodhuesit.

Kontraktori duhet te dorezoje tek supervizori per aprovim, metodologjine, ku te perfshihen te gjithë tabelat per vetite e produkteve qe do te perdoren.

Riparimi me betone speciale do matet sipas siperfaqes faktike te riparuar dhe do te aprovohet nga supervizori

Cmimi I riparimit te betoneve do te perfshije te gjitha punimet e nevojshme, paisjet, fuqine punetore dhe materialin e nevojshem.

Nuk do te behen matje per punime shtese si hyrja ne pjesen qe riparohet, adidivet, shtesa perzierse, pastrimet dhe kerkesat per konsolidim, provat dhe lustrimet kur nje gje e tille kerkohet.

4.1 Cilesia e Ujerave

Provat me ujerat nentokesore prane ujeleshuesit kane treguar se nuk ka presence te Sulphate Class DS-2 Aggressive Kimikisht ndaj betoneve, por jane Brenda kufijve te lejuar per t'u perdorur.

Megjithate kontraktori duhet ta kete parasysh kete fakt ne pregatitjen e betoneve.

4.2 Cimento

Cimento qe do te perdoret ne zbatimin e punimeve te betonit duhet te jete Portland e Markes 42,5 kN/mm². Cimento e furnizuar duhet te jete e shoqeruar me pasaporten perkatese te treguesve te saj.

Cimento mbahet ne vende te thata dhe thaset e lagur aksidentalisht duhet te largohen nga kantjeri.

4.3 Inertet

Inertet qe do te perdoren per prodhimin e betonit duhet te jene granile + rere lumi apo guri te thyer te lara e te fraksionuar ne lavatrice. Raporti i perzjerrjes se tyre do te percaktohet ne institucione te licensuara para fillimit te punimeve. Dokumentet perkatese miratohen nga supervizori.

5. Ujeshuesi

Kontraktori do te vere ne dispozicion fuqine punetore dhe te gjitha punimet e nevojshme paraprake qe do te duhen per kryerjen e inspektimit nga supervizori te ujeshuesit.

Kontraktori do te vere ne dispozicion fuqine punetore dhe paisjeve te nevojshme per te kryer te gjitha matjet e nevojshme gjate inspektimit te structures te ujeshuesit.

Inspektimi I ujeshueseve do te kerkoje nje hapesire te mjaftueshme per hyrje sipas nje procedure dhe me nje staf te kontraktorit te trainuar mire me pare.

N dalje Tubat duhet te jene boshatisur plotesisht nga uji duke nenkuptuar edhe pjeset me te ulta per rreth pusetave te ujeshuesve.

Kontraktori duhet te kete siguruar po ashtu edhe fuqi punetore dhe mjetet e nevojshme per ndonje pastrim nga sedimentet, apo cdo pastrim tjeter ne zonen qe do te germohet ne aksin e ujeshuesit.

Tubacioni i ujeshuesit

Tubacioni vendoset i zhytur ne formacion baze, dhe bazamnetet e betonit siç jepet ne vizatime ..

Tuabcioni i duhet te plotesoje te gjitha kushtet teknike per montimin e tij.

Nuk do te mbulohet tubacioni pa u bere me pare prova me ngarkese e tij. Mbulimi te behet vetem pasi te jene bere riparimet qe mund te jene çfaqur gjate provave me ngarkese.en

Ndertimi i pusetave te reja apo riparimet e atyre ekzsituese do te behen sipas vizatimeve perkatese dhe duke mbajtur parasysh edhe zerat e punimeve te specifikuar ne preventiva dhe analizat e cmimeve.

Instalimi i saracineskave do te behet konform kushteve teknike te zbatimit, duke smontuar me pare saracineskat egzistuese.

6. Shkarkuesi katastrofik

6.1 Inspektimi

Aksi i shkarkuesit do te piketohet ne teren ne funksion te kushteve konkrete pas kryerjes se punimeve te germimit.

6.2 Realizimi i punimeve

Pragu i shkarkuesit do te vendoset i zhytur ne formacion baze jo me pak se 0.6 m.

Respektimi i kuotes se pragut te hyrjes se shkarkuesit dhe konfiguracioni i zones se shkarkuesit me uren automosbilistike qe do te ndertohet mbi kete shkarkues realizohen sipas vizatimeve dhe specifikimeve te tjera teknike qe shoqerojne keto vizatime.

6.3 . Ura mbi shkarkues

Per kalimin e mejteve mbi shkarkues , ne projekt eshte parashikuar ndertimi i nje ure auto me HD (hapesire drite) = 4 m dhe gjeresi B= 4 m .

Eshte e domosdoshme qe aksi i ure mbi shkarkues duhet te vendoset patjeter ne nje vije me aksin e diges , dhe aksi i shkarkuesit te jete ne mesin e gjatesise se ures . aksi

.7. Kurora e diges dhe rakordimi me Skarpaten e Bjefit te Siperme

7.1 Veshja me Gure

Siperfaqja ku do te zevendesohet siperfaqja e veshjes me gure per mbrojtjen e skarpates se siperme te diges eshte parashikuar mbi bazen e gjendjes vizuale te objektet gjate kohes se inspektimeve e piketimeve.

Prandaj, nje inspektim nga supervizori ne fillimin te punimeve do te percaktoje me egzaktesi siperfaqet ku duhet te behet ky riparim. Ne preventiv eshte planifikuar qe te riparohet rreth 10% e siperfaqes totale te veshjes me gure.

7.2 Punimet e mbushjes per nivelacion dhe Ngjeshja

Paraprakisht siperfaqja ekzsituese e kurores do te skarifikohet para fillimit te mbushjes sipas vijave te nivelit te treguara ne vizatimet perkatese.

Per realizimin e mbushjeve te zonave te ulura te argjinatures per nivelimin e kurores diges sipas kuotes se projektit , jane parashikuar te perdoren nje apo dy shtresa me

mbeturina kave me trashesi $t=15$ cm (shih vizatimin) dhe nje shtrese stabilizanti me trashesi $t= 10$ cm.

Para se te filloje mbushjen Kontraktori duhet te kete ne dispozicion nje volum te mjaftueshem per mbushjen dhe ngjeshjen sipas standarteve te kerkuar, ose ne te kundert ai duhet te riskarifikoje siperfaqen e kurores.

Ngjeshja do te behet me rul pa vibrim. Ne prani te supervizorit do te behen disa prova per percaktimin e lageshtise optimale dhe per percaktimin e numrit te kalimeve te rulit per te arritur Gamen e Skeletit.

Keto prova duhet te shoqerohen me nje procesverbal i cili firmoset nga Kontraktori dhe Supervizori. Ky dokument ben pjese ne dosjen e dorezimit te punimeve

7.3 Parapeti

Pas rinivelacionit te kurores se diges eshte parashikuar qe mbi kreun e kurores, te ndertohet nje parapet ose mur prites i vales ne lartesi jo mme pak se 50 cm mbik kuoten e projektit

Detajet struktura dhe armimi i parapetit jepen ne vizatimet e veçanta .

8. Matjet dhe pagesat

Matjet per inspektimet dhe pagesat do te jene te nje formati te aprovuar qe te konfirmojne punimet, duke l dorezuar edhe ne menyre dixhitale tek supervizori.

Pagesa do te behet sipas zerave te parashikuara ne preventiv, bazuar ne kontraten e nenshkruar me klientin.

Kontraktori eshte pergjegjes per saktesine e matjeve dhe volumeve te punimeve te kryera qe parashikohen te situacionohen. Te gjithë volumet do te konfirmohen me librezat e masave, dokumente te cilat bejne pjese e dosjes se dorezimit te objektit.

Asnje punim nuk do te paguhet para se te merret raporti l supervizorit qe konfirmon realizimin e volumeve apo arsyetimet per ndonje ndryshim te tyre.

Kontraktori do te jete pergjegjes per materialet, kantjerin dhe personelin qe do te duhet per realizimin e punimeve.

Nese do te jete e nevojshme, punimet mund te kerkohet qe te kryhen ne menyre te pjeseshme sipas nje grafiku te detajuar ne menyre qe te shmanget gjate ndertimit ndonje mbikalim uji mbi trupin e diges.